

UDHËZUES

Fuqizimi i Integritetit të Informacionit tek të Moshuarit



Co-funded by
the European Union



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Stampe Kosova

Hyrje dhe qëllimi i Udhëzuesit

Të dashur lexues,

Mirë se vini në këtë udhëzues të thjeshtë që kemi përgatitur posaçërisht për ju, për të ju ndihmuar që të jeni më të sigurt dhe më të informuar kur lexoni lajme, veçanërisht ato që i shihni në telefonat tuaj, veçanërisht në Rrjetet Sociale.

Ky udhëzues ka për qëllim që t'ju mësojë, hap pas hapi, si të dalloni lajmin e vërtetë nga ai i rremë. Sot lajmet nuk i gjejmë më si dikur nëpër gazetatat që i merrnim në dorë çdo mëngjes.

Që nga viti 2020, në Kosovë nuk ka më gazeta të shtypura ditore. Tani shumica e lajmeve gjenden vetëm në internet, pra në telefonat tuaj, kompjuterët, apo faqe të ndryshme posaçërisht në Facebook.

Por një gjë ka mbetur si dikur:

Televizioni vazhdon të jetë burimi më i besueshëm për shumicën e njerëzve.

Shumë prej jush informoheni ende përmes lajmeve që shikoni çdo mbrëmje në transmetuesin publik, televizionet me frekuencë nacionale, por edhe në ato lokale. Kjo është shumë pozitive, megjithëse ndonjëherë, në telefon apo Facebook, përballemi me lajme që nuk janë të vërteta.

Prandaj, ky udhëzues do t'ju ndihmojë që:

- të kuptoni se cilat lajme janë të sigurta,
- cilat nuk duhen besuar,
- dhe si të kërkonti ndihmë kur keni dyshime.

Ju nuk keni nevojë të jeni ekspertë të telefonit apo teknologjisë. Mjafton të lexoni me kujdes dhe të mbani mend disa hapa të thjeshtë që do t'i mësojmë së bashku.

Ky udhëzues është për ju – dhe për t'ju fuqizuar në këtë kohë kur lajmet janë kudo, por jo gjithmonë të vërteta.

1. Si funksionon informimi sot?

Sot lajmet nuk vijnë vetëm nga televizioni. Ato vijnë prej shumë vendeve. E disa janë të sakta, disa përpos që nuk janë të sakta, kanë edhe qëllim të përçojnë agjenda të caktuara.

Për ta kuptuar më mirë se si marrim lajmet sot, duhet të dimë ku i marrim ato. Pra, cilat janë burimet?

Llojet e mediave që na informojnë:

- Televizioni: Ky është mediumi që shumica prej jush e shikoni çdo ditë. Shembull: RTK, RTV 21, KTV, ATV, Klan Kosova, RTV Dukagjini, TV lokale si TV Festina apo TV Prizreni.
- Radioja: Shumë prej nesh kemi dëgjuar radio që në rini. Disa ende e dëgjojnë për lajme në mëngjes, apo kur janë në makinë.
- Media online: Këto janë uebfaqe apo portale, që shkruajnë lajme dhe ju mund t'i lexoni me telefon apo kompjuter. Format i është i ngjajshëm me lajmet në gazetë, mirëpo vinë më shpejtë dhe më në kohë reale, sepse interneti i sjell tek ne shumë shpejt. Shembull: Kallxo.com, Koha.net, Gazeta Express, Telegrafi etj.
- Rrjetet sociale: Facebook, TikTok, YouTube. Këto NUK janë media klasike, por njerëzit shpesh shpërndajnë aty lajme që kanë lexuar diku – ose shpesh edhe lajme të rreme.

1.1 Cili është dallimi mes mediave të vërteta dhe faqeve që vetëm shpërndajnë?

Mediat tradicionale (televizioni, radioja, gazetatat të njohura) kanë gazetarë që hulumtojnë, intervistojnë, kërkojnë burime të besueshme, pyesin burime të tjera, kontrollojnë/verifikojnë lajmet para se t'i publikojnë. Operojnë bazuar në Kodet e Etikës dhe principet bazë të gazetarisë.

Platformat digjitale, si Facebook apo YouTube, nuk kontrollojnë gjithmonë çka po shpërndahet. Aty çdokush mund të postojë çfarë të dojë, edhe pa e ditur nëse është e vërtetë apo jo. Shumica e faqeve në platformat digjitale, të cilat ne i përdorim si rrjete për socializim (Rrjetet Sociale) kanë pas tyre individë të cilët i përdorin për komunikim me audiencat e veta, ashtu sikur ne që i përdorim profilet tona private. Prandaj, nëse niseni nga parimi i postimeve tuaja, atëherë kuptohet se ne nuk marrim leje, intervistojmë apo domosdoshmërisht hulumtojmë për atë që po shkruajmë, njëjtë veprojnë edhe këto faqe të cilat pretendojnë se janë media jo-tradicionale.

Shembull konkret

Zonjës Drita nga Ferizaj iu shfaq një postim në Facebook, në formë lajmi, ku thuhet se pensionet do të rriten për 50 euro. Ajo e shpërndau menjëherë, e gëzuar. Por lajmi nuk ishte i vërtetë, ishte vetëm një postim nga një faqe e panjohur, që nuk kishte asnjë lidhje me Qeverinë apo edhe nuk kishte ndonjë burim të besueshëm.

Po të kishte pritur pak dhe ta kontrollonte në ndonjë nga faqet që ajo i lexon, të priste edicionet e lajmeve në Televizion apo edhe në radio, ose të kërkonte me një kërkim të thjeshtë në Google faqen e Ministrisë së Financave, do ta kuptonte që ishte dezinformatë.

1.2 Pse është me rëndësi të dimë se prej ku vjen lajmi?

Nëse nuk e dimë burimin, pra kush e ka shkruar, kush e ka publikuar, dhe a është person apo media e besueshme, mund të biem fare lehtë pre e tyre.

Pyetjet bazë që duhet t'ia parashtrtojmë vetes:

- A është ky një televizion i njohur?
- A është kjo një faqe serioze?
- A e njoh emrin e gazetarit apo medias?
- A jam informuar ndonjëherë nga ky medium apo gazetarë?

Nëse përgjigja është "Jo", mos e besoni menjëherë. Kërkoni vetë dhe verifikoni. Nëse nuk e gjeni në burimet e besueshme të lajmeve, në televizionin që e ndiqni, apo edhe në portalet tradicionale, atëherë gjasat janë shumë të mëdha që lajmi nuk është i vërtetë.

1.3 Mediat e lira dhe të sakta janë shumë të rëndësishme për një shtet demokratik.

Në një vend demokratik si Kosova, qytetarët duhet të kenë të drejtë të informohen saktë dhe drejt. Vetëm kështu mund të votojmë me dije, të mbrojmë të drejtat tona dhe të kuptojmë çfarë po ndodh rreth nesh. Kur kemi media të forta e të lira, kemi edhe demokraci më të fortë dhe qytetarë më të vetëdijshëm.

2. Çka është dezinformimi dhe lajmi i rremë?

Jo gjithçka që lexojmë apo dëgjojmë është e vërtetë. Disa lajme janë të shpikura, të rrejshme, ose të qëllimshme për të na mashtruar. Këto quhen lajme të rreme.

2.1 Çfarë do të thotë “lajm i rremë”?

Një lajm i rremë është një informacion që duket si lajm i vërtetë, por në fakt është gënjeshtër. Mund të përhapet në Facebook, TikTok, YouTube, ose edhe nga njerëz që vetë nuk e dinë që është i pavërtetë.

Shembull konkret

Në një grup të Facebook-ut të fshatit, dikush poston:

“Mos merrni vaksinën e gripit – është vdekjeprurëse!”

Ky është lajm i rremë. Askund në lajmet zyrtare nuk thuhet kështu. Asnjë mjek, asnjë televizion serioz nuk e ka thënë këtë. Përkundrazi një kërkim i thjeshtë tek Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, qoftë në faqen e tyre në Facebook, apo edhe në lajmet e mediave tradicionale, e demanton këtë lajm i cili nuk është i vërtetë, apo i bazuar shkencërisht. Fatkeqësisht, lajmi përhapet shpejt dhe i frikëson shumë qytetarët, sidomos të moshuarit.

2.2 Çfarë është “dezinformimi”?

Dezinformimi është kur dikush qëllimisht përhap lajme të pavërteta për të përfitur apo për të ngjallur frikë, urrejtje ose për të manipuluar njerëzit. Këto përhapen nga grupe të caktuara të interesit, që kanë për qëllim të përçojnë agjenda të caktuara (kryesisht të dëmshme) tek qytetarët. Këto “lajme” shpërndahen me qëllimin

Ka edhe një formë tjetër:

Keqinformim, që do të thotë kur dikush shpërndan lajme të rreme pa e ditur që janë të rreme. Këtu qytetarët bëhen pjesë aktive e shpërndarjes së informatave jo të vërteta, mirëpo pa qëllime të këqija. Kjo ndodhë për shkak se janë dezinformuar nga burime të caktuara, ndërsa e shpërndajnë lajmin pa dashur të bëjnë dëm të qëllimshëm. Përkundrazi, besojnë që po kontribuojnë në shpërndarjen e informatave tek personat me të cilët janë të rrjetëzuar apo shoqërohen.

2.3 Ku i hasim më së shpeshti lajmet e rreme?

- Në Facebook, ku ndonjë faqe ose person anonim shkruan një postim senzacionalist
- Në WhatsApp, ku na vjen një video ose mesazh “dërgoje edhe tek të tjerët”
- Në YouTube, ku dalin video me tituj të frikshëm, pa asnjë fakt
- Në disa faqe anonime, që nuk tregojnë kush i drejton dhe nuk kanë gazetarë të identifikuar

2.4 Si ndikojnë këto lajme tek ne?

Kur besojmë lajme të rreme, ndodh që:

- Frikësohemi pa arsye
- I tregojmë të tjerëve një gënjeshtër, duke e përhapur edhe më shumë
- Gabojmë në vendimet tona (p.sh. për shëndetin, votën, ose ndihmat sociale)
- I humbim besimin institucioneve dhe mediave të vërteta

2.5 Si ta kuptoni nëse një lajm është i dyshimtë?

Nëse një lajm ju duket shumë i çuditshëm, shumë i frikshëm, ose shumë i mirë për të qenë i vërtetë, atëherë ndaloni një çast. Mos e besoni menjëherë. Mos e shpërndani.

3. Si ta njohim një lajm të rremë?

Jo çdo lajm që lexoni në Facebook, apo që ju vjen në telefon, është i vërtetë. Disa gjëra që shkruhen aty nuk janë lajme fare. Po si mund ta kuptoni këtë?

Ka disa shenja që mund t'ju ndihmojnë. Nëse veproni bazuar në këtë, do ta keni më të lehtë të gjeni se çfarë të besoni e çfarë jo.

3.1. *Titulli është shumë i frikshëm ose shumë i bukur për të qenë i vërtetë*

Nëse shihni diçka si:

“QEVERIA PO I NDAL PENSIONET NESËR!”

“PIJE KËTË ÇAJ DHE SHËROHESH NGA TË GJITHA SËMUNDJET!”

Këto janë tituj që duan vetëm t'ju trembin ose t'ju mashtrojnë që ta klikoni lajmin.

Lajmet e vërteta nuk përdorin fjalë që frikësojnë ose bëjnë panik.

3.2. *Nuk tregon se kush e ka shkruar*

Lajmet e sakta kanë gazetarë dhe media të njohura që nënshkruhen me emër dhe mbiemër.

Nëse lajmi nuk ka as emër autori, as emrin e medias: MOS E BESONI!

3.3. *Nuk ka burime të tjera që e thonë të njëjtën gjë*

Nëse një lajm është i vërtetë, do ta gjeni në disa media p.sh. në RTK, në Koha.net, në Kallxo.com, Telegrafi, ATV etj.

Shembull praktik:

Nëse lexoni në një faqe në Facebook që “do të ketë ndihma për të moshuarit nesër”, kontrolloni a po e thotë këtë ndonjë televizion apo gazetë online serioze. Nëse po e lexoni lajmin në Facebook, kërkoni edhe në faqen e Ministrisë së Financave gjithashtu.

Nëse nuk e gjetët në faqet e besueshme, mos bini pre e kësaj dezinformate!

3.4. Ka shumë gabime në të shkruar dhe nuk është shkruar qartë

Lajmet e rreme shpesh janë shkruar keq, me fjalë që nuk kanë kuptim, me gabime drejtshkrimore.

Një media para se ta publikojë lajmin e redakton, lekturon dhe më pas e plasën. Personat të cilët qëndrojnë pas faqeve që kanë për bazë dezinformimin dhe shpërndarjen e informatave jo të sakta, nuk i kanë aftësitë e përpunimit të lajmit.

3.5. Ju shtyn që ta shpërndani menjëherë

Nëse shihni diçka që thotë:

- **“Ndaje këtë menjëherë me familjarët!”**
- **“Mos e mbaj për vete – lajmi nuk është sekret!”**

Kjo është shenjë që lajmi është i rremë. Sepse lajmet e vërteta nuk ju detyrojnë t'i shpërndani. Mediat tradicionale nuk përfshihen me lexuesin, ato e informojnë sakt, drejtë dhe në kohë. Nuk kërkojnë shpërndarje, komente apo iniciativa që lidhen me lajmin.

Kur shihni inkurajime të tilla, ku kërkohet përfshirja e juaj si qytetarë, atëherë kjo ka të bëjë krejtësisht me klikimet të cilat monetizohen në Rrjetet Sociale nga qarkullimi/trafiku në postimet e tyre.

Nëse një lajm ju duket i dyshimtë, veproni kështu:

- Mos e shpërndani menjëherë.
- Kërkoni lajmin në Google që t'ju drejtojë në një faqe tjetër më serioze.
- Pyetni një familjar, ose iu qasni një mediumi që i besoni. Fundja, interesohuni edhe në faqet e Institucioneve apo Organizatave që mund të lidhen me lajmin.

4. Si të verifikoni lajmin?

(A është e vërtetë apo është dezinformatë? Ja si ta kuptoni vetë)

Shpesh, kur shihni një lajm në Facebook apo ju vjen në Viber, nuk jeni të sigurt nëse është i saktë apo jo. Mos u ndiej keq, nuk duhet të jeni ekspert për ta kuptuar.

Mjafton të bëni disa hapa të thjeshtë. Mësoni t'i bëni pyetje lajmit, si një detektiv fillestar!

4.1. KUSH E KA PUBLIKUAR KËTË LAJM?

Shikoni emrin e faqes ose emrin e medias.

Nëse e ka publikuar RTK, Klan Kosova, Koha.net, Kallxo.com – mund ta besoni.

Por nëse lajmi vjen nga ndonjë faqe e çuditshme si “Lajmet e fundit në Kosovë 24/7” ose “Sekrete të fshehta”, dhe nuk e njihni fare, mos i besoni menjëherë!

Këshillë: Në fund të faqes (kur shkoni poshtë), mediat serioze kanë të shkruar: “Rreth nesh”, “Kontakt”, “Kush jemi” etj, shikoni nëse ekziston apo ka informata rreth mediumit. Në shumicën e rasteve i kanë të dhenat si emaili, numri i telefonit, adresa/qyteti. Ato faqe të cilat nuk posedojnë asnjë gjurmë të ekzistencës së tyre, sipas të gjitha gjasave NUK janë media.

4.2. A KA DIKUSH TJETËR QË E KA PUBLIKUAR KËTË LAJM?

Nëse e shihni një lajm në Facebook, kontrolloni:

“A e ka publikuar edhe ndonjë televizion tjetër?”

“A e përmendin këtë lajm edhe në lajmet e mbrëmjes?”

“A e ka përmendur ndonjë ministër ose institucion zyrtar?”

Shembull:

Nëse lexoni: “Nesër do të jepen ndihma në para për të moshuarit në çdo komunë”

→ Shikoni në faqen e Komunës, mediat tuaja të besueshme, Ministrinë e Financave

→ Nëse askush tjetër nuk e thotë, mos e merrni si të mirëqenë, sepse gjasat janë të mos jetë i vërtetë.

4.3. A ËSHTË LAJMI I PLOTË, APO VETËM NJË PJESË E VOGËL?

Disa lajme tregojnë vetëm një fjali apo një video të shkurtër, që mund të jetë keqkuptim.

Këshillë:

Nëse e shihni një video që thotë:

“Shikoni çfarë ndodhi me politikanin X!”

por nuk jep asnjë shpjegim tjetër, ka shumë të ngjarë që nuk është e vertetë apo nuk ka fare përmbajtje që është lajm. Kryesisht është “karrem” për të sjellur klikime të cilat i monetizojnë. Sa më shumë klikime që ne bëjme në tituj të tillë, aq më shumë iu sjellim përfitime financiare këtyre personave.

4.4 A KA SHENJA QË ËSHTË LAJM I RREMË?

Rikujto shenjat nga faqja e kaluar.

- Titull shumë i frikshëm ose shumë i bukur për të qenë i vërtetë
- Gabime në të shkruar
- Nuk ka autor apo emri i medias tingëllon i çuditshëm
- Ju shtyn ta shpërndani menjëherë

Nëse i ka disa prej këtyre, atëherë nuk është për t’u besuar.

4.5. SI TA KONTROLLONI NË GOOGLE (EDHE NËSE S’JENI SHUMË I ZOTI ME TELEFON)

Nëse përdorni telefon të mençur (smartphone), bëni këtë:

- Mbani gishtin pak mbi titullin e lajmit dhe kopjojeni tekstin
- Hapni Google (mund të pyesni edhe një familjar si ta bëni këtë një herë)
- Kopjoni lajminn aty
- Shikoni nëse dalin edhe media të tjera (apo faqe zyrtare) që e thonë të njëjtën gjë

Nëse po, është më e besueshme.

Nëse jo, bëni kujdes.

4.6. PYETENI DIKË QË E KUPTON MË MIRË

Nuk është turp të pyesësh. Nëse nuk jeni të sigurt për një lajm:

- Pyetni nipin, mbesën, vajzën, djalin, ata kryesisht dinë si ta verifikojnë/kontrolojnë
- Ose telefononi një mik apo dikë që i ndjek lajmet

Mjafton një një telefonatë e vogël apo një kërkim i thjeshtë, për të mos rënë në kurth.

Në fund, kujtoni këtë rregull të thjeshtë:

“Mos beso gjithçka që lexon. Fillimisht pyete: A është kjo e vërtetë?”

Nëse nuk jeni i sigurt, mos e shpërndani.

4.7. Në cilat media mund të keni më shumë besim në Kosovë?

Sot ka shumë faqe në internet, shumë video, shumë lajme që vijnë nga gjithandej, nga Facebook-u, nga YouTube-i, nga TikTok-u apo Instagram-i, nga njerëz të panjohur që shkruajnë apo krijojnë video, pa u bazuar as në burime, e as në etikën gazetareske. Është normale të ndiheni të hutuar ndonjëherë. Por për fat të mirë, në Kosovë kemi disa media që njihen për punën e tyre serioze, për gazetarët që raportojnë me kujdes dhe për lajmet që kontrollohen para se të publikohen.

Nëse doni të dini se çfarë po ndodh në vend, në komunën tuaj apo në Kosovë, televizioni mbetet njëri nga burimet më të sigurta për shumë prej jush. Për shembull, kanale si RTK (Radio Televizioni i Kosovës), KTV, RTV 21, ATV, TëVë1, Kanal 10, Klan Kosova apo RTV Dukagjini janë televizione që punojnë çdo ditë me gazetarë që raportojnë nga terreni, që intervistojnë burime të besueshme dhe që japin lajme të verifikuara.

Nëse jeni nga ata që ende dëgjoni radio, atëherë mund të mbështeteni edhe në Radio Kosova, Paper Radio, A Radio, Radio Prishtina, Radio Dukagjini, Glam Radio etj, të cilat transmetojnë lajme të përditshme dhe emisione edhe informative edhe edukuese, për qytetarët.

Për ata që përdorin telefon të mençur (smartphone) dhe hyjnë herë pas here në internet, ka disa faqe të besueshme ku mund të lexoni lajme të sakta dhe të kontrolluara. Ndër më të njohurat janë Koha.net, Kallxo.com, Gazeta Express, Telegrafi, Radio Evropa e Lirë e të tjera, që njihen nga publiku për punë serioze dhe për faktin që e respektojnë kodin e etikës.

Një mënyrë e mirë për të kuptuar nëse një faqe është e besueshme, është të shikoni nëse ajo tregon se kush është redaktori, ku gjendet zyra e tyre, dhe a kanë kontakt të hapur me publikun. Në fund të faqeve të tilla zakonisht shkruhet "Rreth nesh", "Kush jemi" apo "Na kontaktoni". Nëse nuk e kanë këtë fare, ose nëse faqja duket sikur është hapur vetëm për të bërë zhurmë, është mirë të dyshoni.

Një tjetër gjë e rëndësishme është të dini se jo çdo faqe në Facebook është media e vërtetë. Disa faqe në Facebook duken sikur janë gazeta, por në të vërtetë nuk kanë gazetarë, nuk kanë përgjegjësi dhe mund të publikojnë çdo gjë vetëm për të mbledhur klikime. Mbi të gjitha, asnjëherë mos u mbështetni vetëm te Facebook-u për lajme. Në vend të kësaj, kërkoni faqet zyrtare të mediave serioze, ku shumë prej tyre kanë edhe aplikacione që mund të shkarkohen në telefon, ose thjesht i vizitoni përmes Google-it.

Për më shumë siguri, mund të kontrolloni nëse portali është anëtare e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK). Kjo organizatë kujdeset që mediat të respektojnë etikën dhe të mos publikojnë lajme të rreme apo fyese. Po ashtu, për televizionet dhe radiot, përgjegjëse është Komisioni i Pavarur për Media (KPM), i cili e kontrollon dhe e rregullon mënyrën se si këto media funksionojnë.

Nëse nuk jeni të sigurt në ndonjë lajm që keni parë, mos hezitoni t'i shkruani ndonjërit prej televizioneve që i ndiqni. Mund t'i dërgoni një mesazh në faqen e tyre në Facebook, apo të pyesni dikë që u besoni për ta kontrolluar bashkë. Mediat serioze kryesisht do të përgjigjen në pyetjet tuaja, pra nuk i mërzisni, përkundrazi, ata janë bashkëpunues për t'ju ndihmuar të merrni informata të sakta.

Pra, gjithmonë kini parasysh këtë: më mirë të kontrolloni një herë më shumë sesa të shqetësoheni apo shpërndani diçka që ka për qëllim të ju dëmtojë.

5. Kush kujdeset për etikën dhe respektimin e saj në media?

(Kush i mban mediat “nën kontroll” që t’i respektojnë Kodet Etike?)

Ndonjëherë mund të keni parë lajme fyese, të pavërteta, apo emisione ku njerëzit shahen e ofendohen. Ose ndodh që një gazetar shkruan diçka që nuk është e saktë dhe askush nuk jep sqarim. Po kush merret me këtë? Kush ua tërheq vërejtjen mediave?

Në Kosovë ekzistojnë dy trupa kryesore që kujdesen për etikën dhe se sa po e respektojnë mediat atë.

5.1. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)

Ky trup merret me mediat që shkruajnë lajme, pra gazetatat online si Koha.net, Kallxo.com, Gazeta Express, etj.

- KMSHK është një organizatë e cila funksionon si trup vetërregullues, pra është e krijuar nga vetë gazetarët për të ruajtur etiken profesionale.
- KMSHK ka një Kod Etik, i cili është një rregullore që tregon se si duhet të sillen gazetarët dhe mediat kur shkruajnë.
- Nëse ndiheni të ofenduar nga ndonjë artikull, ose mendoni se një lajm është i padrejtë apo i rremë, mund të bëni ankesë në KMSHK.

Shembull konkret:

Zotëri Iliri nga Gjilani lexoi një artikull ku përmendej emri i tij, por lajmi ishte i pasaktë dhe nuk ishte pyetur fare për mendim. Ai e kontaktoi KMSHK-në dhe, pas shqyrtimit, gazeta u detyrua të kërkojë falje dhe ta korrigjojë lajmin.

5.2. Komisioni i Pavarur për Media (KPM)

Ky trup rregullues merret me televizionet dhe radiot. Ai është një institucion i pavarur i shtetit që kontrollon licencat dhe rregullat që duhet t'i ndjekin TV-të dhe radiot.

KPM kujdeset që programet të mos përmbajnë gjuhë urrejtjeje, fyerje publike, ose lajme të rreme.

KPM ka të drejtë të ndëshkojë një televizion nëse ai shkel rregullat, qoftë me paralajmërim, gjobë, apo edhe pezullim.

KPM po ashtu pranon ankesa nga qytetarët. Nëse mendoni që një emision jeni fyer ose është shpërndarë informacion i rrejshëm, mund të raportoni në këtë institucion.

Si të bëni ankesë?

Për të dy këto trupa, nuk keni nevojë për ndonjë dokument zyrtar apo njohuri të veçanta. Mjafton një ankesë e thjeshtë me emrin tuaj dhe një shpjegim të shkurtër:

- ✓ Çfarë keni parë?
- ✓ Kur ka ndodhur?
- ✓ Pse mendoni që ishte e padrejtë apo e rrejshme?

Ankesën mund ta dërgoni përmes:

- E-mailit
- Fizikisht

Ose kërkonti ndihmë nga ndonjë organizatë, si **AGK (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës)**, që mund t'ju ndihmojë me hapat.

Mbani në mend:

- Ju keni të drejtë të kërkonti informata të sakta.
- Dhe keni të drejtë të ankoheni kur kjo e drejtë nuk respektohet.

6. Rekomandime për informim të sigurt dhe të përgjegjshëm

Përmes këtij Udhëzuesi, kemi shpjeguar se si të moshuarit mund të forcojnë aftësinë e tyre për të dalluar informacionin e saktë nga ai i rremë, veçanërisht në një mjedis mediatik gjithnjë e më të ndërlikuar. Duke marrë parasysh se shumë prej qytetarëve mbi moshën 65 vjeçare nuk janë rritur me teknologji dhe nuk kanë qenë më parë kaq të ekspozuar ndaj informatave të shumta dhe shpesh të pa verifikuara, është e nevojshme që informimi i tyre të mbështetet në parimet bazë.

Ky Udhëzues është vetëm një hap drejt fuqizimit të të moshuarve në fushën e informimit. Rritja e vetëdijes mediatike është proces që vazhdon, dhe për këtë qëllim, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe partnerët e vet do të vazhdojnë të ofrojnë mbështetje dhe informacion të përshtatur për të gjitha grupmoshat.

Qytetarët e moshuar janë pjesë e rëndësishme e shoqërisë dhe kanë të drejtën të informohen në mënyrë të sigurt, të dinjitetshme dhe të saktë. Duke ndjekur këto udhëzime të thjeshta, secili prej jush mund të mbrojë veten dhe të ndihmojë edhe të tjerët të mos bien pre e dezinformimit.

Më poshtë janë disa rekomandime shumë praktike, të cilat janë përmbledhur nga përvoja e vetë të moshuarve që kanë marrë pjesë në takimet tona në Prishtinë, Gjakovë, Suharekë dhe Istog.

1. Mos shpërndani lajme pa i lexuar tërësisht dhe pa i verifikuar.

Shumë lajme që përhapen në Facebook apo ËhatsApp janë të shkurtuara me qëllim që të mashtrojnë. Lexoni gjithmonë të gjithë përmbajtjen dhe kërkoni burimin para se të vendosni ta shpërndani mëtej.

2. Mos pranoni të intervistoheni në rrugë nga media të panjohura.

Ka raste kur persona pa asnjë (jo-gazetarë) ju afrohen në rrugë me mikrofon apo kamera dhe paraqiten si media. Nëse nuk e njihni intervistuesin, nuk shihni logo që e keni parë në televizor ose nuk jeni të sigurt për qëllimin e intervistës, refuzoni me mirësjellje.

3. Mos e besoni një lajm vetëm sepse shoqërohet me video apo zë të fortë. Shumë video që qarkullojnë janë të vjetra, të montuara ose të shkëputura nga konteksti. Asnjë video nuk është dëshmi nëse nuk dihet kur është regjistruar dhe nga kush.

4. Mos u mbështetni vetëm në rrjetet sociale për informim. Facebook, TikTok, Instagram apo YouTube nuk janë media. Ato janë platforma ku çdokush mund të postojë çfarë të dojë. Përdorni mediat që njihen për punën e tyre të verifikuar dhe që janë të regjistruara në Kosovë.

5. Konsultohuni me një familjar ose me media të njohura kur keni dyshime. Nëse nuk jeni të sigurt për vërtetësinë e një lajmi, kërkoni ndihmë nga dikush i besueshëm, familjar, fqinj apo media. Kjo është mënyra më e sigurt për të shmangur keqinformimin.

6. Mos e shpërndani lajmin për “çdo rast”. Shumë prej lajmeve që mund të duken të rëndësishme, janë të rreme ose të ekzagjeruara. Nëse nuk jeni të sigurt, më mirë mos e shpërndani fare.

Shënim: Qëndrimet dhe përmbajtja e këtij udhëzuesi pasqyrojnë pikëpamjet e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve tanë.